

VENDIM
Nr.1144, datë 5.8.2008

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË AUTOSTRADËS “THUMANË -RROGOZHINË”, DHE MIRATIMIN E
BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET
SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues, për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (Ndërtim, operim dhe transferim), të autostradës “Thumanë-Rrogozhinë” është Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

2. Miratimin e bonusit prej 4 pikësh, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse, propozim i pakërkuar, që i jepet shoqërisë “Konstruktor-Inzenjering d.d” Split, Kroaci.

3. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha